



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT DHE UJIT

V E N D I M

Nr. 31, datë 30.03.2026

**PËR MIRATIMIN E SHTYRJES SË AFATIT TË LEJES SË NDËRTIMIT PËR
OBJEKTIN: “PËRSHTATJEN E AMBJENTEVE TË BRENDSHME TË OBJEKTIT
“INKUBATORI I BIZNESIT” NË ZYRA PËR STRUKTURËN E POSAÇME KUNDËR
KORRUPSIONIT DHE KRIMIT TË ORGANIZUAR SI DHE NDËRTIMI I URËS
LIDHËSE MIDIS DY OBJEKTEVE EKSIZTUESE”, ME VENDNDODHJE NË
BASHKINË TIRANË**

Në mbështetje të neneve 27, 28 të Ligjit Nr. 107, datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar, si dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.519, datë 20.09.2017 “Për përcaktimin e përbërjes së Këshillit Kombëtar të Territorit”, i ndryshuar, me propozim të subjektit zhvillues Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, Këshilli Kombëtar i Territorit dhe Ujit,

VENDOSI:

1. Miratimin e shtyrjes së afatit të Lejes së Ndërtimit të objektit: “Përshtatjen e ambjenteve të brendshme të objektit “Inkubatori i Biznesit” në zyra për strukturën e posaçme kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar si dhe ndërtimi i Urës lidhëse midis dy objekteve eksiztuese”, me vendndodhje në Bashkinë Tiranë, me zhvillues Prokurorinë e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar (SPAK), miratuar me Vendimin Nr. 08, datë 02.07.2024 të Këshillit Kombëtar të Territorit (sot KKTU).
2. Afati i kryerjes së punimeve sipas këtij Vendimi, do të pasqyrohet në Dokumentin e Lejes së Ndërtimit, në përputhje me afatin e përcaktuar në grafikun e punimeve.
3. Ngarkohet Agjencia e Zhvillimit të Territorit në bashkëpunim me Ministrinë e Drejtësisë, për zbatimin e këtij vendimi.
4. Vendimi, pasi nënshkruhet nga Kryetari i Këshillit Kombëtar të Territorit dhe Ujit, Ministri i Linjës dhe Sekretari i Këshillit Kombëtar të Territorit dhe Ujit, hyjnë në fuqi menjëherë.



MINISTËR I LINJËS

MINISTËR I DREJTËSISË

TONI GOÇU



ANËTAR / SEKRETAR I KKT

DREJTOR I AGJENCISË SË ZHVILLIMIT TË TERRITORIT

ADELAJDA ROKA



Nënshkruar më datë 29 04 / 2026